



**BASHKIA E TIRANËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr.41, datë 23.09.2015**

**Për**

**“RIORGANIZIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME NR.1 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT DHE KRIJIMIN E AGJENCISË SË PARQEVË DHE REKREACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8, pika 1/VI shkronja “b”, nenit 32, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pikat 2 dhe 3, nenit 44 shkronja “i” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(i ndryshuar); ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”(i ndryshuar); nenit 37 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; nenit 2, shkronja “c”, nenit 5, shkronja “a” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008 për “Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 20.07.2011 për “Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 956, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e kurorës së gjelbër të Tiranës dha masat për mbrojtjen e saj”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.56, datë 24.12.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa Institucioneve në varësi të Bashkisë së Tiranës”; vendimit të këshillit bashkiak nr.28, datë 23.12.2014 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit me një numër të përgjithshëm prej 360 (treqind e gjashtëdhjetë) punonjësish. Detyrat funksionale të këtij institucioni do të jenë si më poshtë vijon:
  - a) administrimi i mirëmbajtjes, zhvillimit, pastrimit të gjelbërimit rrugor dhe të gjelbërimit të zonave të banimit brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
  - b) administrimi i pastrimit të zonave të pambuluara nga operatorët e kontraktuar nga Bashkia e Tiranës.
  - c) krijimi, mirëmbajtja dhe pastrimi i lulishteve dhe shatrivaneve brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
  - d) prodhimi dhe furnizimi me lule dhe bimësi për çerdhet, kopështet dhe shkollat nën administrimin e Bashkisë së Tiranës.

- e) administrimi i Landfill-it të Tiranës dhe evadimi i mbetjeve sipas nevojave dhe urdhëresave të Bashkisë së Tiranës.
2. Të miratojë krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës me një numër të përgjithshëm prej 200 (dyqind) punonjësish. Detyrat kryesore funksionale të këtij institucioni do të jenë si më poshtë vijon:
    - a) administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve memoriale (Varrezat e Dëshmorëve Tiranë dhe Pezë) brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
    - b) zhvillimi, Administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve rekreative (përfshirë parkun zoologjik), historike dhe natyrore brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
    - c) kthimi i parqeve, nëpërmjet planifikimit dhe projekteve, në zona rekreative të frekuentueshme nga çdo grup moshe.
    - d) mbrojtja e kurorave të gjelbra dhe inspektimi i respektimit të zonave të gjelbra brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
  3. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit sipas lidhjes së pagave nr.15, bashkëlidhur këtij vendimi.
  4. Të miratojë stemën zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
  5. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe Buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2015, duke reflektuar shtesat dhe pakësimet brenda Programit të Shërbimeve Publike Vendore, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
  6. Në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi strukturat organizative të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit i paraqiten për miratim Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, me marrjen e këtij vendimi.
  7. Në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi të përgatiten rregulloret për funksionimin e brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, të cilat do të paraqiten për miratim tek Kryetari i Bashkisë së Tiranës, jo më vonë se 30 ditë pas miratimit të strukturave organizative.
  8. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit për ndjekjen e procedurave të ndarjes së aseteve, mjeteve të punës, inventarit fizik, ambienteve dhe arkivës të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit.
  9. Pika 1, shkronja (a) e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 56, datë 24.12.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa institucioneve në varësi të Bashkisë së Tiranës” shfuqizohet.
  10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik,

Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për zbatimin e këtij vendimi.

11. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R**

ALDRIN DALIPI